

**UNMIK RREG/2001/34**  
**31 Dhjetor 2001**

---

**RREGULLORE NR. 2001/34**

**NDRYSHIM I RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2000/64 PËR CAKTIMIN E  
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NDËRKOMBËTARË DHE  
NDRYSHIMIN E VENDIT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e pranisë ndërkombëtare civile për ruajtjen e të drejtave qytetare dhe për mbrojtjen e avancimin e të drejtave të njeriut,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/6 të datës 15 shkurt 2000 mbi Emërimin dhe largimin nga vendi i punës i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë,

Pas nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000 mbi Caktimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe ndërrimin e vendit,

Duke marrë parasysh faktin se prania e vazhdueshme e kërcënimeve ndaj sigurisë mund të minojë edhe pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë dhe të pengojë aftësinë e gjyqësisë që t'i ndjekin krimet penalisht në mënyrë të duhur, që rëndë minon procesin e paqes dhe vendosjen e plotë të sundimit të ligjit në Kosovë,

Në pajtim me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 dhe me qëllim të vazhdimin të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64,

Me anë të kësaj ndryshohet Rregullorja UNMIK-ut nr. 2000/64 duke reviduar nenin 4.

Neni 1  
Ndryshimi

Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/64 që nga data e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi, do të ketë formulimin e mëposhtëm:

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 dhjetor të vitit 2000 dhe mbetet në fuqi deri më 15 dhjetor të vitit 2002. Pas shqyrtimit, periudha për të cilën kjo Rregullore mbetet në fuqi mund të vazhdohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 2  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 15 dhjetor të vitit 2001.

Hans Haekkerup,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm